



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 104/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 05.12.2016, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Aleanca Kosova e Re (AKR), dega Prishtinë

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.12.2016, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datën 03.12.2016, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është thyer heshtja zgjedhore duke paraqitur sloganin nëpërmjet portale online “Kosova Press” dhe “Gazeta Tribuna” gjatë kohës së heshtjes zgjedhore. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e informoi lidhur me ankesën Anr.104/2016 të datës 04.12.2016, të parashtruar nga ana e AKR, dhe kërkoi që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 05.12.2016 në ora 12:00.

PZAP-i, brenda afatit pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën konsiderojnë se pretendimet ankimore të paraqitura nga AKR lidhur me shkeljen e nenit 4 i cili nen nuk është i përcaktuar për cilin ligj është fjala.

Gjithashtu sipas përgjigjes në ankesë të PDK-së, ankesa e AKR-së dhe fotografitë e bashkangjitura si dëshmi nuk përmbajnë orën as datën se për të ditur se në cilën kohë është publikuar reklamimi i posterit, kështu që këto dëshmi mun të jenë të marra gjatë fushatës zgjedhore gjë që është e lejuar dhe jo siç pretendohet gjatë heshtjes zgjedhore.

PDK konsideron se nuk kanë prova konkrete nga AKR lidhur me shkeljen e nenit 4, dhe kërkon nga PZAP-i që ta hedhë poshtë këtë pretendim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga fotografit e ofruara si prova të cilat gjinden në shkresat e lëndës nuk vërehet dhe nuk mund të vërtetohet koha e publikimit të reklamës në portale online “Kosova Press” dhe “Gazeta Tribuna” dhe nuk mund të identifikohet koha se a është gjatë fushatës zgjedhore apo gjatë heshtjes zgjedhore, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante, prandaj sipas nenit 5.7 pika b) dhe c) i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, duke u bazuar edhe dispozitat e nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr.104/2016 më datën 05.12.2016

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

